



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:292925  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05426552

AA.nr.366/2023

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A.C, nga Podujeva, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3030/2019, të datës 09.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Miratohet si e bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë.

**II.** Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3030/2019, i datës 09.03.2023.

**III.** Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A.C nga Podujeva, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me nr. të dosjes 203033 të datës 01.11.2019.

**IV.** Mbetet në fuqi vendimi i paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me nr. të dosjes 203033 i datës 01.11.2019, me të cilin vendim është refuzuar ankesa e z/znj A.C, me numër të ID-së:... për Njohjen e të Drejtës në Kategorizim për Pension me shkollim të mesëm.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.1171/2019, të datës 14.07.2021, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A.C nga Komuna e Podujevës. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është anuluar vendimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-

Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (DAPRK) në Prishtinë, me dosje 203033, i datës 01.11.2019, ndërsa paditësit i njihet e drejta në kategorinë e pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është obliguar Ministria e e Financave, Punës dhe Transfereve -Departamenti i Pensioneve (MPMS-DP) në Prishtinë, që paditësit, ti njihet e drejta në kategorinë pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme, ashtu që në të ardhmen në baza mujore ti paguhet shuma adekuate për këtë lloj pensioni, si dhe ti kompensoj diferencën e pa paguar nga data e parashtrimit te kërkesës 05.05.2016 deri me datën 31.12.2018, diferencën e pagës sipas pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore te mesme ne vlere prej 14 euro ne muaj – gjithsejtë shumen prej 448 €, ndërsa nga data 01.01.2019 e deri me datën 28.02.2023 t’ia kompensoje shumën prej 16 euro ne muaj, përkatësisht shumen e tërësishme prej 800 euro, pra gjithsejtë periudha 1+2 rezulton te jete 1,248.00 euro. Nën pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit është vendosur qe ky aktgjykim i zëvendëson aktet administrative të anuluar dhe ka karakter detyrues.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura përmes përfaqësueses së autorizuar të saj, Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë ashtu që refuzohet padia në tërësi si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 par.1 të LKA-së, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:

### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me vendimin me nr. të dosjes 203033 të datës 01.11.2019, e ka refuzuar ankesën e z/znj A.C, me numër të ID-së:... për Njohjen e të Drejtës në Kategorizim me shkollim të mesëm.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 18.12.2019, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe jo i ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar duke vendosur ne dispozitiv të aktgjykimit te ankimuar. Me arsyetim se vendimi i kontestuar përmban të meta për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij, po ashtu vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, me që nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Gjykata e shkallës së parë për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, i’u referua Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenit 8 paragrafit 1 gjithashtu iu referua edhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, i cili në nenin 5 par.2 dhe 3, përcakton se: 2“*Shfrytëzuesi i pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti,*

*përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme*". Nga provat në shkresat e lëndës, vërtetohet se paditësi ka kryer shkollën e mesme - përgatitje shkollore të mesme, dhe se ka bashkangjitur dokumente relevante si, "Diploma e kryerjes së arsimit të mesëm me numër të protokollit 271/72 – numër rendor i librit të amzës 1106 i datës 28.06.1973, ku ceket se kreu - arsimin e mesëm, vërtetimi i datës 26.04.2016 i lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës e datës 26.04.2016, ku ceket se kreu "degën në komunikacion – vozitës, pranë shkollës së nxënësve në Ekonomi në Zveçan". Nga provat e cekura rezulton se paditësi i plotëson kriteret e përcaktuara me dispozitat e lartcekura.

Mbi këtë bazë, gjykata e shkallës së parë vlerëson se vendimi i të paditurës i goditur me padi, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara më lartë dhe me provat në shkresat e lëndës dhe vlerësoi se i njëjti duhet të anulohet. Gjykata e shkallës së parë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që baza juridike e kërkesëpadsisë është vërtetuar sipas provave të gjetura në shkresat e lëndës, deklaratave të palëve në procedurë dhe bazës ligjore, andaj, konform nenit 43 par.3 lidhur me nenin 46 par.4, vendosi vet çështjen administrative, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo për faktin se këtë e lejon karakteri i çështjes dhe të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës, japin bazë të sigurt për këtë gjë. Si rrjedhojë e kësaj, vendosi që paditësit t'i njihet e drejta në Pension Kontributpagues të Moshës me Përgatitje Shkollore të mesme, pasi që baza e kërkesëpadsisë i është krijuar me anulimin e vendimeve. Gjykata e shkallës së parë shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës, por të njëjtat i vlerësoi si të pabazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje juridike dhe në këtë mënyrë vendimin kontestues gjykata e vlerëson me të meta juridike i cili duhet të anulohet. Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që vendimin e atakuar e bëjnë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin, respektivisht vendimi i atakuar nuk është bazuar fare në dispozitat të cilat rregullojnë çështjen këtu të caktuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes vlerëson se aktgjykimi i goditur, është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së. Andaj, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ti përkrah si të rregullta dhe të ligjshme, sepse argumentet në të cilat bazohet për fakte vendimtare gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, nuk janë bazuar në gjendjen e fakteve të administruara në baza ligjore si në vendimin e kontestuar. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar provat relevante, ndryshe, andaj ekzistojnë kundërthënie në mes asaj që në arsye të aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumenteve, e që si pasojë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale. Duke shqyrtuar vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me nr. të dosjes 203033 të datës 01.11.2019 dhe aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, kjo gjykatë gjen se vendimi i të paditurës MPMS-DP është i plotë në përmbajtjen e tij, dhe është i bazuar në prova dhe argumente nga palët ndërgjyqëse, nga të cilat vërtetohet në mënyrë të plotë gjendja faktike e çështjes. Ndërsa, aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të lartcekura, kjo për faktin se vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga përmbajtja e vendimit të të paditurës dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton që paditësi nuk ka përmbushur kushtet dhe kriteret në kuptim të nenit 5 par.5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues për arsye se

kualifikimi shkollor nuk është në harmoni me kornizën ligjore me vetë faktin që përgatitja shkollorë-vërtetimi nr.1043 dt.26.04.2016 i vërtetuar te Noteri nuk mund të merret si bazë për vendimmarrje nga se është në kundërshtim me pikën 5 të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues. Sepse nga ky dokument shihet se paditësi me afatin e gushtit të viti shkollor 1972/73 nga dt.28.01.1973 deri me dt.06.029.1973 ka kryer degën e komunikacionit-vojitës. Andaj nga kjo rezulton se paditësi nuk e ka të kryer shkollën e mesme sepse një mundësi e tillë nuk ka ekzistuar që në një afat prej 7(muajve) të kryhet arsimimi i mesëm. Ndërsa Diploma e personit tjetër Sh.A, nuk mund të merret si provë relevante. Andaj, në bazë të këtyre fakteve, pretendimet e paditësit se ka paraqitur prova të mjaftueshme lidhur me të drejtën në kategorinë e pensionit kontributpagues me përgatitje të shkollës së mesme, sipas dokumenteve të paraqitura nuk janë të bazuara, ngase siç u theksua më lartë vërtetimi nr.143 i vërtetuar te Noteri nuk mund të merret si baze për vendimmarrje meqë është në kundërshtim me nenin 5 par.5 të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

Kolegji i Gjykatës së Apelit gjatë shqyrtimit të ankesës, lidhur me ligjshmërinë e vendimit kontestues, ankesën e të paditurës e vlerëson si të drejtë dhe të bazuar në ligj, ngase nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit. Andaj, kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se gjendja faktike në këtë çështje administrative është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, i cili vendim është në harmoni me dispozitat ligjore të lartcekura të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe Udhëzimi Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

Andaj, kolegji i kësaj gjykate duke u bazuar në nenin 183.1, 194 dhe 201.1 b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, e duke i vlerësuar shkresat dhe provat të cilat gjenden në lëndë, dhe vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, konstaton gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, kështu që nga shkaqet e cekura më lartë, kolegji i Gjykatës së Apelit vendosi që aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3030/2019, të datës 09.03.2023, ta ndryshoj dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me nr. të dosjes 203033 të datës 01.11.2019, me të cilin vendim është refuzuar ankesa e A.C, me numër të ID-së:... për Njohjen e të Drejtës në Kategorizim me shkollim të mesëm, në bazë të së cilit është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike e çështjes, dhe drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore dhe procedurale, dhe e drejta materiale.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 195.1 pika e) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.366/2023, me datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit,  
Ramiz Kuqi